



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT NË KOSOVË - 2023

Shtator, 2024

MISIONI

“Rregullim i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

VIZIONI

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	6
2.	PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE.....	8
2.1	PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJE	8
2.1.1	Cilësia e Ujit	8
2.1.2	Mbulueshmëria me shërbime të ujësjes	9
2.1.3	Matja e ujit	10
2.1.4	Ankesat e konsumatorëve	11
2.1.5	Konsumatorët e prekur nga presioni i ulët.....	12
2.1.6	Vazhdimësia e furnizimit me ujë.....	13
2.1.7	Defektet në rrjetin e ujesjes.....	15
2.1.8	Uji i pa faturuar (Uji i humbur).....	15
2.1.9	Volumi i ujit të faturuar (shitur).....	17
2.2	PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË	20
2.2.1	Vlera monetare e shitjeve.....	20
2.2.2	Kostoja për njësi	21
2.2.3	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	21
2.2.4	Kostoja operative për njësi të ujit të shitur.....	22
2.2.5	Kostoja njësi e ujit të shitur, realizimi kundrejt planifikimit	23
2.2.6	Investimet kapitale per ujësjes	24
2.3	PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA	27
2.3.1	Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara.....	27
2.3.2	Shpeshësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit.....	27
2.3.3	Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)	28
2.3.4	Ankesat për shërbimet e ujërave të ndotur	28
2.4	PERFORMANCA FINANCIARE-SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA.....	30
2.4.1	Faturimit (shitjet) volumetrike të shërbimeve të ujërave të ndotura	30
2.4.2	Vlera monetare e realizuar e faturimit (shitjeve) të shërbimit të ujërave të ndotura.....	30
2.4.3	Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura	31
2.4.4	Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura	31
2.5	PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E OFRUESVE TË SHËRBIMIT.....	34
2.5.1	Arkëtimi i të ardhurave.....	34
2.5.2	Kthimi ne kapital	35
2.5.3	Shpenzimet operative.....	36
2.5.4	Efikasitet i stafit.....	38
3.	PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË	40
4.	BESUESHMËRIA DHE SAKTËSIA E TË DHËNAVE.....	41
SHTOJCA 1:	BESUESHMËRIA E TË DHËNAVE - 2023.....	44
SHTOJCA 2:	TREGUESIT E DATAJUAR TË PERFORMANCËS.....	45

SHTOJCA 3:	RASQYRAT PËRMBLEDHËSE TË ARDHURAVE	59
SHTOJCA 4:	PËRMBLEDHJE TREGUESISH - 2023	62
SHTOJCA 5:	TË DHËNA STATISTIKORE - 2023	63
SHTOJCA 6:	PASQYRAT TARIFORE (2022-2023).....	64

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRR	Baza Rregullatore e Aseteve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
PR	KRU "Prishtina", Prishtinë
PZ	KRU "Hidroregjioni Jugor", Prizren
PE	KRU "Hidrodriini", Pejë
MIT	KRU "Mitrovica", Mitrovicë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
GJA	KRU "Gjakova", Gjakovë
FE	KRU "Bifurkacioni", Ferizaj
GJI	KRU "Hidromorava", Gjilan

1. HYRJE

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) ndien kënaqësi të veçantë, që për publikun dhe palët e interesuara dhe të involvuara në sektorin e ujit, të bëjë publik 'Raportin Vjetor të Performancës për Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit në Kosovë për vitin 2023'. Raporti shqyrton dhe analizon performancën e 7 (shtatë) Kompanive Rajonale të Ujit (KRU), të cilat kanë statusin e ndërmarrjeve publike, me përgjegjësi për të ofruar shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullim dhe trajtim të ujërave të ndotura në Kosovë, dhe të Ndërmarrjes Hidro-Ekonomike Ibër Lepenci, e cila furnizon ujë me shumicë të pa trajtuar për KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Mitrovica'.

Monitorimi dhe raportimi mbi performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, në mënyrë specifike kundrejt objektivave të performancës dhe efikasitetit që kemi vendosur në kuadër të proceseve rregullatore, është përgjegjësi ligjore dhe funksionale e ARRU-së. Në këtë mënyrë ARRU, siguron që konsumatorët të marrin shërbime me cilësi të garantuara në pajtueshmëri me kornizën ligjore të aplikueshme.

Analiza e performancës pasqyrohet përmes një numri të kufizuar të treguesve kyç të performancës, të cilët janë prezantuar në formë të dhënave statistikore të bazuara kryesisht në informacione / të dhëna të raportuara nga kompanitë në raportimet e tyre të rregullta periodike tre-mujore dhe vjetore në ARRU dhe të dhëna të audituara / verifikuara nga ARRU. Raporti Performancës vlerëson: trendet e zhvillimit (progresin /stagnimin) e performancës së KRU-ve për vitin 2023 në raport me vitin 2022 dhe nivelin e përmbushjes së objektivave të aprovuara të ofruesve të shërbimit për vitin aktual.

Vlerësimi i performancës së KRU-ve, për vitin raportues 2023, tregon se KRU-të vazhdojnë të ofrojnë një nivel relativisht të kënaqshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara për konsumatorët, por nuk përformojnë mirë kundrejt objektivave të tyre të efikasitetit financiar dhe operativ.

Në përgjithësi performanca e KRU-ve për vitin 2023 në Kosovë është më e dobët se parashikimet/pritjet në shumicën e treguesve kyç të performancës. Vëllimi i ujit të humbur (uji i pafaturuar - UPF) në nivel sektori është afërsisht 111.5 milion m³, që shprehur në përqindje përbën 61% të ujit të prodhuar. Kjo është përqindje shumë e lartë dhe e pa pranushme, kur dihet se në disa regjione ka mungesë të theksuar të furnizimit të rregullt të konsumatorëve me ujë të pijshëm.

Fusha ku është shënuar përmirësim i dukshëm gjatë vitit 2023 është shkalla e arkëtimit që ka arritur në nivelin prej 102% në raport me faturimin, po ashtu ka pasur rritje të arkëtimit edhe në raport me vitin 2022 afërsisht për 13%. Është për t'u theksuar si zhvillim pozitiv për faktin se KRU-të kanë arritur të mbledhin një shumë të konsiderueshme të borxheve të vjetra që nga këndvështrimi i ARRU-së mund të jetë përmirësim afatshkrutër. Megjithë këtë përmirësim, KRU-të kanë rritur në mënyrë jo-proporcionale shpenzimet operative, e veçanërisht zërin e pagave për personelin, e kjo ka kufizuar mundësitë e KRU-ve për realizimin e investimeve të planifikuara kapitale prej buxhetit vetanake, fakt ky shumë shqetësues për ARRU-në.

Vonesat dhe dështimet e vazhdueshme për përtëritjen / zëvendësimin me kohë të segmenteve më kritike të rrjetit shpërndarës të ujit, ndryshimi i destinimit të projekteve infrastrukturore të aprovuara me proces tarifor, ekzekutimi i punëve me kualitet të dobët bën që gjendja e infrastrukturës së ujit të përkeqësohet.

Vërehet një përmirësim për sa i përket instalimit të ujëmatësve për konsumatorët e rinjë, qoftë nga investitorët (objektet kolektive të banimit) dhe nga vet KRU, mirëpo ka ngecje sa i përket përmbushjes së kërkesave ligjore dhe standardeve teknike të ujëmatësve. Në këtë aspekt KRU-të kanë dështuar të planifikojnë zëvendësimin periodik dhe ripërtëritjen me kohë të infrastrukturës matëse të ujit, si dhe tolerimin e konsumatorëve të instalojnë ujëmatës që nuk plotësojnë standardet minimale teknike.

Nga këndvështrimi i ARRU-së, të dy çështjet e sipërme, mos realizimi i përtëritjes vjetore të rrjetit të ujit dhe zëvendësimin në kohë të ujëmatësve, janë faktorë me ndikim për nivelin kaq të lartë të humbjeve të ujit. Po ashtu faturimi i konsumatorëve sipas gjendjes së supozuar tek një numër i konsumatorëve shtëpiak është në kundërshti me standardet e shërbimit.

Mbledhja, analiza dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara nga KRU-të është objektiv së cilës i ka kushtuar vëmendje të veçantë ARRU. Informacioni i saktë dhe i besueshëm është një mekanizëm i rëndësishëm për planifikim dhe vendimmarrje të drejtë për çështje kyçe zhvillimore të kompanive dhe qëndrueshmëri për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe të sektorit në përgjithësi. Rrjedhimisht një prej kërkesave adresuar KRU-ve është përmirësimi dhe avancimi i sistemit për menaxhim të dhënave, digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve interne dhe veçanarisht digjitalizimi i infrastrukturës me të cilën menaxhojnë dhe operojnë KRU-të.

ARRU është e përkushtuar që sfidat e sektorit ti adresojë me KRU-të dhe të punojë bashkarisht me palët e interesit me qëllim të përmirësimit, rritjes së efikasitetit dhe efijencës së shërbimeve. Në këtë kontekst, ARRU shprehë mirënjohjen ndaj donatorëve për mbështetje të sektorit për investimet e bëra në ripërtëritjen e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e instalimeve të reja.

Ne shpresojmë se ky raport vjetor i performancës, do t'i ndihmojë ofruesit e shërbimeve të rrisin performancën e tyre, si dhe të përmirësojnë shërbimet e sektorit të ujit të pijshëm për popullatën e Kosovës. Shpresojmë gjithashtu që të dhënat dhe informatat e publikuara në këtë raport të shfrytëzohen nga institucionet vendore dhe donatorët, të përfshirë në sektorin e ujit, që gjatë planifikimit të mbështetjes së sektorit, të adresojnë problemet më madhore të sektorit dhe të ketë koordinim midis palëve para se të investohet.

ARRU shprehë mirënjohje për stafin e KRU-ve për raportim të dhënave dhe për stafin e ARRU-së për hartimin e Raportit të Performancës të ofruesve të shërbimit për vitin 2003.

2. PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

2.1 PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJE

2.1.1 Cilësia e Ujit

Cilësia e ujit të pijshëm është njëri nga standardet kryesore të shërbimit të cilin ofruesit e shërbimeve janë të obliguara ta përmbushin. Është inkurajuese që të gjitha KRU-të kanë hartuar Planin për Monitorim të Kualitetit të Ujit, i aprovuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK) dhe që KRU-të kanë ndërtuar dhe ngritur kapacitetet monitoruese dhe testuese të kualitetit të ujit këtë vit. Përveç KRU Mitrovica që ka një laborator mjaftë mirë të pajisur por jo të akredituar, KRU-të tjera kanë akredituar laboratorët e tyre për pjesën e testeve fiziko-kimike, e për pjesën e testeve bakteriologjike kanë nënshkruar kontratë shërbimi me IKSHPK sipas kërkesave në Udhëzim Administrativ.

Edhe në këtë raport, analiza dhe vlerësimi i cilësisë kundrejt standardeve në fuqi të kualitetit të ujit, është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga IKSHP; ARRU ka mundur të siguroj informacione edhe nga testimet e bëra në kuadër të laboratorëve të KRU-ve. Niveli i përputhshmërisë së kualitetit të ujit, i prezantuar në diagramin 1 dhe 2, tregon përqindjen e testeve që janë në përputhje me standardet e aplikueshme dhe shprehë raportin midis numrit të testeve që janë në përputhje me standardet ndaj numrit të përgjithshëm të testeve të kryera; kjo vlen si për testet fiziko-kimike dhe bakteriologjike.




Figura 1. Përputhshmëria e testeve bakteriologjike

Në aspektin bakteriologjik, gjatë vitit 2023, janë marrë dhe testuar 13,486 mostra të ujit në nivel sektori, dhe në përputhje me standardet kanë qenë 98.7% e tyre. KRU 'Bifurkacioni' ka normën më të ulët të përputhshmërisë së testeve bakteriologjike me vetëm 87.5%, që është shumë më e ulët se KRU-të tjera, madje më e ulët se sa në vitin 2022. Reshjet e vrullshme atmosferike, mungesa e vazhdimësisë së furnizimit me ujë, ndërprerjet e shpeshta të ujit për shkak të plasjeve / dëmtimeve në gypat e ujësjellësit janë listuar si faktorë dominantë të cilët kanë ndikuar në dështimet e testeve bakteriologjike.




Figura – 2. Përputhshmëria e testeve fiziko-kimike

Nga aspekti i përputhshmërisë së testeve fiziko – kimike, uji i pijshëm në vitin 2023 në raport me vitin 2022, është në nivel më të ultë të përputhshmërisë. Nga numri total prej 13,217 të mostrave fiziko-kimike të testuara, 97.4% e tyre janë në përputhje me standardet e aplikueshme.

Siç shihet nga figura 2, KRU ‘Hidrodrini’ ka përqindjen më të ulët të përputhshmërisë prej 90%, ndonëse në raport me vitin 2022 ka bërë progres. Në aspektin fiziko-kimik, dy nga parametrat kryesor që më së shpeshti nuk kanë qenë në përputhshëri janë turbullira, e ndikuar kryesisht nga reshjet a vullshme atmosferike, dhe përqendrimi i ulët i klorit rezidual në pikat ku janë marrë mostrat e ujit për testim.

Në fund të vitit 2023, nga IKSHPK dhe KRU Prishtina, jemi njoftuar se në ujin e papërpunuar në liqenin akumulues në Badovc ishte konfirmuar përqendrim më i lartë i manganit, i cili edhe pas përpunimit të ujit në impiantin në Badovc, nuk kishte mundur të largohej në përputhje me standardet e aplikueshme. Kjo situatë me shfaqje të manganit duket të jetë dukuri e përvitshme, me dallim se këtë vit situata duket se ka qenë më kritike, në aspektin e kohëzgjatjes dhe përqendrimit të manganit. KRU Prishtina ka njoftuar se pas disa javësh kishte arritur të zgjidhë këtë problem, megjithatë është rekomanduar që të hulumtohen arsyet dhe shkaqet e shfaqjes së manganit në këtë periudhë të vitit dhe të ndërmerren masa parandaluese.

2.1.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

KRU si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura sigurojnë shërbime të ujësjellësit tek 79% e popullatës – siç është prezantuar në figurën 3. Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohet nga sistemet e menaxhuara nga KRU në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.

Në grupin prej 21% të numrit të banorëve që nuk janë ligjërisht të menaxhuara nga KRU-të, bëjnë pjesë një numër i konsiderueshëm i sistemeve rurale, të cilat ofrojnë shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, mirëpo popullata nuk janë pajtuar që sistemet e tyre të menaxhohet nga KRU duke preferuar kështu menaxhimin individual (të pa-ligjshëm). Edhe komunat e veriut dhe jug-lindjes së Kosovës nuk janë të integruara, e as të licencuara të ofrojnë shërbime të ujit hyjnë në këtë kategori. Në këto raste rekomandohet angazhim më i madh institucional në vetëdijësimin e këtyre banorëve për pasojat e konsumit të ujit të pa-përpunuar dhe të pa-kontrolluar dhe degradimit të aseteve në rast të mungesës së mirëmbajtjes së rregullt të tyre.




Figura 3. Përqindja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësllësit

Përveç KRU 'Hidromorava', ofruesit e tjerë të shërbimeve nuk kanë raportuar ndryshime në shifra për shtrirje të shërbimeve gjatë vitit 2023 në raport me vitin 2022. Nga të gjitha regjionet, KRU 'Gjakova' ka shtrirjen më të lartë të shërbimeve me ujësllësit me 99% mbulueshmëri të zonës së shërbimit, përderisa KRU 'Hidromorava' me 63% dhe 'Hidroregjioni Jugor' me 66% kanë raportuar mbulueshmërinë më të ulët me shërbime të ujësllësit në zonat të tyre respektive të shërbimit. Ofruesit tjerë të shërbimeve kanë mbulueshmëri midis 79% dhe 85%, ndërsa në nivel sektori mbulueshmëria me shërbime të ujësllësit ka mbetur e njejtë në 79%. Numri i konsumatorëve të shërbyer nga KRU-të aktualisht është rreth 462,398, nëse krahasohet me vitin paraprak ky numër është më i madh për rreth 25,777 apo shprehur në përqindje rritje prej 6% të numrit të konsumatorëve.

Të dhënat për numrin e banorëve nëpër regjione janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) të bazuara në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 dhe projeksionit të ASK-së për shtim të banorëve për vitin 2023.

2.1.3 Matja e ujit

Përveç obligimit ligjor që KRU-të kanë për të fatuar konsumatorët e tyre në mënyrë të saktë, të drejtë sipas gjendjes së lexuar në ujëmatës, matja e ujit është gjithashtu një mjet i domosdoshëm për menaxhimin efikas të zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe për nxitjen e konsumatorëve për kursimin e ujit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për KRU-të të cilat përballen me sfidën e plotësimit të nevojave të popullsisë së tyre me ujë të pijshëm.




Figura 4. Përqindja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Analiza e rezultateve tregon se mbulimi i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2023 është 99.1%. Nga numri total prej 462,398 konsumatorë, vetëm 3,062 konsumatorë ende nuk janë të pajisur me ujëmatës, kryesisht konsumatorë shtëpiak. Edhe pse është bërë progres në zvogëlimin e numrit të konsumatorëve pa ujëmatës, KRU 'Mitrovica' mbetet kompania me numrin më të lartë të konsumatorëve që nuk kanë ujëmatës, me 2,158 konsumatorë pa ujëmatës që pasohet nga KRU 'Prishtina' me 475 sish.

Sa i përket mirëmbajtjes dhe zëvendësimit periodik të ujëmatësve, shumica e ofruesve të shërbimeve të ujit nuk kanë plan të menaxhimit të ujëmatësve edhe pse ky plan kërkohet të hartohet sipas rregulloreve të brendshme të KRU-ve. Kjo situatë është edhe më shqetësuese duke marrë parasysh faktin se numër shumë i madh i ujëmatësve, që janë të instaluar tek konsumatorët, janë më të vjetër se 6 vite, madje ka ujëmatës me vjetërsi mbi 10 deri 25 vjet që ende janë në funksion, faktorë kryesor që ndikon shumë në saktësinë e regjistrimit të ujit të shpenzuar, e gabimet reflektohen në vëllimin e ujit të faturuar dhe humbjet e ujit. Ujëmatësit e vjetër zakonisht regjistrojnë më pak, rrjedhimisht janë në dëm të ofruesve të shërbimit. Korniza ligjore e aplikueshme e Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK) kërkon zëvendësimin / verifikimin e ujëmatësve të konsumatorëve çdo 5 vjet. Pra, matja e ujit në çdo pikë konsumi është mekanizmi kryesor për menaxhimin e humbjeve dhe racionalizimin e shfrytëzimit të ujit.

Kapacitetet për testimin e saktësisë së regjistrimit dhe për riparimin / kalibrimin e ujëmatësve në Kosovë janë të kufizuara. KRU 'Gjakova' dhe KRU 'Prishtina' kanë punëtorë të reja, të ndërtuara në vitet e fundit për testimin / riparimin / kalibrimin e ujëmatësve me kapacitet më të madh, por të dy këto punëtorë nuk kanë akreditim / licencim nga institucionet përgjegjëse dhe legalisht nuk janë funksionale. Punëtorja në KRU 'Hidroregjioni Jugor' është akredituar dhe është funksionale, por kapaciteti i kësaj punëtorie është relativisht i vogël dhe mezi i plotëson nevojat e KRU 'Hidroregjioni', ndërsa punëtorja për testim të ujëmatësve në KRU 'Hidromorava' është jashtë funksionit që disa vite. Edhe për këtë çështje, duke qenë se janë të ndërtuara objektet, kërkohet dhe rekomandohet të ushtrohet shtytje tek KRU-të të akreditojnë dhe funksionalizojnë punëtoritë e tyre për testim / kalibrim dhe riparim të ujëmatësve.

2.1.4 Ankesat e konsumatorëve

Ky tregues paraqet numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga KRU-të, prej konsumatorëve të tyre për shërbimin e ujësjellësit dhe paraqet një formë shprehjeje të pakënaqësisë që paraqitet në formë të shkruar apo përmes thirrjes telefonike në qendrat e thirrjes apo tek personat përgjegjës nëpër KRU. Përditësimi, klasifikimi dhe analiza e ankesave të konsumatorëve janë elemente të

rëndësishme të monitorimit dhe përmirësimit të performancës, pasi ankesat e konsumatorëve ofrojnë informacione rreth pikave të dobëta në ofrimin e shërbimeve.

Natyra e ankesave duhet të shërbejë si këmbanë alarmi për KRU-të se ku duhet fokusuar dhe çfarë duhet përmirësuar dhe përfundimisht mund të shërbejë si tregues për matjen e kënaqëshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara.

Tabela 1. Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit¹

KRU	Ankesat teknike		Ankesat komerciale	
	2022	2023	2022	2023
PR	2,912	2,813	1,658	1,701
PZ	1,988	2,590	681	757
PE	2,431	4,596	247	43
MIT	4,440	244	141	176
GJA	0	1,430	264	300
FE	64	943	303	316
GJI	273	2,224	518	412
Totali	12,108	14,840	3,812	3,705

Numri i madh i ankesave të raportuara tek KRU-të është një sinjal i mirë që konsumatorët janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar që për ankesat e tyre në lidhje me shërbimet e ujit të parashtrojnë ankesë tek ofruesit e shërbimit. Në anën tjetër dallimi i madh në numrin e ankesave nga viti në vit është tregues se jo të gjitha KRU-të kanë në përdorim aplikacione të dizajnuara mirë për mirëmbajtje, përditësim, klasifikim dhe monitorim të statusit të ankesave. Ankesat teknike kanë shënuar rritje për 23% (në këto shifra janë përfshirë njoftim, lajmërimet si dhe ankesa direkte teknike lidhur me ndërprerjet e ujit, mungesë presioni, cilësi e ujit etj.), përderisa ankesat e raportuara komerciale (të cilat kanë të bëjnë me: mbingarkesat në fatura, lexim jo i rregull i ujëmatesit, shenime të pasakta, mos regjistrimi në kohë i pagesave të kryera), janë zvogëluar për 3% krahasuar me vitin paraprak.

ARRU i ka kushtuar vëmendje çështjes së azhurnimit dhe mirëmbajtjes së aplikacionit të ankesave të konsumatorëve. Besueshmëria e të dhënave është avancuar për faktin se të gjitha KRU-të kanë module të avancuara softuerike të regjistrimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve, të gjitha KRU-të po ashtu kanë edhe procedura të shkruara për të zgjidhur ankesat në përputhje me kornizën ligjore. ARRU ka vërejtur përmirësime në zbatimin e procedurave të trajtimit të ankesave komerciale. Në rastin më të mirë baza e të dhënave të konsumatorëve është më e besueshme tek KRU ('Hidromorava', 'Bifurkacioni', 'Prishtina', dhe 'Hidroregjioni jugor') në anën tjetër përditësimi i ankesave tek KRU 'Hidrodrini' dhe 'Mitrovica' lenë shumë për të dëshiruar.

2.1.5 Konsumatorët e prekur nga presioni i ulët

KRU-të janë të obliguara të furnizojnë në vazhdimësi konsumatorët e tyre me ujë me presion të mjaftueshëm në rrjetin e ujësjellësit. Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ulët, duke përfshirë rastet aksidentale të herë pas herë të rënies së presionit.

Është evidente se menaxhimi i presionit në rrjetin shpërndarës, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara të ujit, është metodë e rëndësishme për menaxhimin e humbjeve të ujit si dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së rrjetit të ujësjellësit.

¹ Referenca: Të dhënat statistikore në Tab.1, janë të raportuar/ Inspektuar sipas formatit –Moduli i standardeve të shërbimit




Figura 5. Pronat e ndikuara nga presioni ulët

Gjatë vitit 2023 katër KRU (Hidrodrini, Hidroregjioni Jugor, Hidromorava dhe Prishtina) kanë raportuar për një numër të konsumatorëve tek të cilët nuk është arritur të sigurohet presioni minimal – siç është treguar në figuren 5. Në përgjithësi të dhënat e presionit të ujit janë vlerësuar me besueshmëri të ultë për faktin se asnjëra nga KRU-të nuk ka të instaluar manometra në pikat kyçe të rrjetit / zonës së shërbimit për monitorimin e presionit në rrjetin shpërndarës dhe nuk kanë të ndarë rrjetin në zona presioni. Në parim ky nuk duket të jetë problem shumë i madh për faktin se ankesat e konsumatorëve për këtë aspekt janë të pakta. Duke qenë se është standard shërbimi, KRU-të duhet të bëjnë përpjekje që të përmirësojnë sistemin e monitorimit dhe menaxhimit të presionit pasi është element i rëndësishëm në menaxhimin e humbjeve të ujit.

2.1.6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Monitorimi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë pasqyron treguesin e performancës i cili merr për bazë numrin e pronave të prekura / ndikuara nga disponueshmëria me shërbim të furnizimit me ujë dhe është ndarë në tre kategori: prona që kanë furnizim 24 orë në ditë, prona që kanë furnizim midis 18-23 orë në ditë dhe ato me më pak se 18 orë furnizim në ditë.

Në përgjithësi, furnizimi me ujë në Kosovë është përmirësuar në vazhdimësi si rezultat i investimeve në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në të gjitha KRU-të, megjithatë furnizimi i vazhdueshëm për 24 orë në ditë në disa KRU ende nuk mund të sigurohet, ndërsa të dhënat e raportuara për vazhdimësinë e furnizimit me ujë, ARRU i vlerëson të jenë me besueshmëri të ulët, pasi zonat e shërbimit ende nuk janë të ndara në zona të matura të ujit (DMA – District Metered Area) përmes të cilave do të monitorohej furnizimi i rregullt me ujë i konsumatorëve.

Tabela 2. Vazhdimësia e furnizimit me ujë e konsumatorëve

KRU	<18 h furnizim %		18-23 h furnizim %		24 h furnizim %	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
PR	4.03%	6.47%	2.16%	0.85%	93.81%	92.68%
PZ	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
PE	6.00%	2.29%	0.00%	0.00%	94.00%	97.71%
MIT	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
GJA	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
FE	1.78%	0.00%	2.31%	1.06%	95.91%	98.94%
GJI	2.62%	0.60%	0.00%	0.42%	97.38%	98.97%

Tabela 2 paraqet të dhënat e raportuara të vazhdimësisë së furnizimit me ujë gjatë vitit 2022 dhe 2023. Vetëm KRU 'Hidroregjioni Jugor', KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Gjakova' kanë raportuar furnizim të rregullt me ujë, katër KRU-të tjera kanë raportuar të kenë ndërprerje të shkurtëra të furnizimit me ujë.

Nga numri i përgjithshëm i konsumatorëve të sektorit të shërbimeve të ujit, rreth 12,500 prej tyre kanë pasur mungesë të vazhdimësisë së furnizimit me ujë, përkatësisht rreth 97% e konsumatorëve është raportuar të kenë pasur furnizim me ujë 24 h në ditë gjatë vitit 2023, 0.4 % e konsumatorëve kanë pasur furnizim 18-24 h në ditë si dhe 2.7% janë furnizuar më pak se 18 orë brenda ditës.

Sipas raporteve, KRU Prishtina ka mbi 10 mijë konsumatorë (7.3%) në zonën e shërbimit që kanë pasur probleme të furnizimi të rregullt me ujë, kryesisht në disa zona në Fushë Kosovë, Podujevë dhe Lipjan. Reduktimet aplikohen me shumë gjatë sezonës së verës, mirëpo reduktimet vazhdojnë edhe gjatë muajve tjerë të vitit për shkak të mungesës së burimeve të ujit dhe keq përdorimeve të ujit.




Figura - 6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Po ashtu edhe KRU Hidrodrini', KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Hidromorava' vazhdojnë të kenë vështirësi në sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit edhe në vitin 2023.

KRU 'Hidromorava', ka deklaruar se kanë aplikuar reduktime të ujit për një numër të vogël të konsumatorëve në disa lokalitete në njësinë operative Gjilan për shkaqe teknike. Ndërsa në KRU 'Bifurkacioni' probleme me mungesë të furnizimit të rregullt paraqiten në disa lokalitete si Komogllavë dhe Gërlicë gjatë sezonës së verës.

Siç është shkruar më lartë, situata në teren mund të jetë edhe më e keqe për sa i përket këtij standardi të shërbimit pasi mungon monitorimi efektiv dhe në kohë reale i shpërndarjes së ujit në zonën e shërbimit. Kompanitë të cilat po ballofaqohen me vështirësi të furnizimit të vazhdueshëm me ujë kanë mundësi të bëjnë më shumë në zbutjen e këtij problemi përmes eliminimit në kohë të defekteve, identifikimi dhe adresimi i kyçjeve të paligjshme (ilegale) të cilat janë burim keqpërdorimi enorm i ujit të pijshëm, ndërmarrjes së fushatave të detektimit të humbjeve të ujit, etj.

2.1.7 Defektet në rrjetin e ujësjellësit

Është një tregues tipik operativ i cili pasqyron gjendjen dhe performancën e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit dhe shprehë numrin total të plasjeve/defekteve të gypave të ujësjellësit brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit.




Figura 7. Defektet e raportuara në rrjetin e ujësjellësit

Në përgjithësi gjatë vitit 2023, performanca e rrjetit të ujësjellësit është përkeqësuar, defektet/plasjet e gypave janë rritur për 14% këtë vit në raport me vitin 2022. Në nivel sektori gjatë vitit 2023 janë regjistruar 193 defekte për 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit, që vlerësohet të jetë numër tejet i lartë, dhe tregon se gjendja e infrastrukturës së ujit është e keqe që pasqyrohet me nivel kaq të lartë të humbjeve të ujit dhe me ndikim potencial negativ në kualitetin e ujit.

Dy inputet kryesore për llogaritjen e këtij treguesi: numri i defekteve / plasjeve (pjesërisht) dhe gjatësia e rrjetit vlerësohet të mos jenë plotësisht të besueshme. Kompanitë kanë aplikacione softuerike për mbajtje të evidencës së defekteve dhe për digjitalizim të rrjetit të ujësjellësit, por azhurnimi i këtyre të dhënave në këto aplikacione ende nuk është në nivelin e duhur.

Performanca e dobët në rrjetin kryesorë të furnizimit, kryesisht është ndikuar nga një sërë faktorësh, duke përfshirë llojin (materialin) e gypave, vjetërsinë e gypave, mungesa e investimeve në ripërtëritjen me kohë të rrjetit, punët jo të mira gjatë instalimit të gypave si dhe mos menaxhimi adekuat i presionit.

2.1.8 Uji i pa faturuar (Uji i humbur)

Uji i pa-faturuar (UPF) paraqet ndryshimin midis vëllimit të ujit të trajtuar dhe të futur në rrjetin shpërndarës në raport ndaj vëllimit të ujit të faturuar, pra është ai vëllim i ujit që humbet para se të arrijë deri tek konsumatori dhe që nuk sjell të ardhura për KRU-të.

Shprehja e humbjeve të ujit në %, megjithëse % nuk është tregues adekuat, na jep një pasqyrë të shpejtë të gjendjes së infrastrukturës së ujit. Aktualisht në nivel sektori në vitin 2023 rreth 61 % e ujit të prodhuar nuk ka arritur të faturohet dhe si i tillë nuk sjell të ardhura për kompanitë. Rritja e UPF krahasuar me vitet paraprake ka ardhur si rezultat i instalimit të ujëmatësve funksional në të gjitha pikat e prodhimit dhe raportimit të ujit të prodhuar sipas leximit të gjendjes në ujëmatës.

Në figurën 8 është prezantuar niveli i UPF sipas KRU-ve individuale dhe në nivel sektori, ku shihet se KRU 'Hidrodrini' me 75 % dhe KRU Hidroregjioni Jugor me 71% të humbjeve të ujit prijnë në raport me të gjitha KRU-të.

Aktualisht të gjitha KRU-të kanë të instaluar ujëmatës funksional në të gjitha burimet e ujit, dhe me kërkesë të ARRU-së, të dhënat e ujit të prodhuar duhet të monitorohen në mënyrë strikte nga personat përgjegjës.




Figura 8. Uji i pa-faturuar (%)

Magnituda e vërtetë e problemit me humbjet e ujit më mirë vërehet kur paraqiten në vlera sasiore absolute. Gjatë vitit 2023 është raportuar vëllim rekord i UPF. Vëllimi i ujit të humbur në nivel sektori është rritur nga 85.6 mil. m³ që ka qenë në vitin 2022 në mbi 111.5 mil. m³ në vitin 2023, siç është paraqitur në figurën 9.

UPF (Vëllimi absolut - m³)




Figura 9. Vëllimi i ujit të pa-faturuar (m³)

Në vitin 2023 nga shtatë KRU-të janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët në total prej rreth 183.4 mil. m³, ndërsa janë faturuar për konsumatorët vetëm 71.9 mil. m³ apo 39%, ndërsa janë humbur mbi 111.5 mil. m³ (61%).

Përndryshe vetëm KRU ‘Gjakova’ dhe KRU ‘Bifurkacioni’ kanë shënuar ulje të UPF në vitin 2023, të gjitha KRU-të tjera kanë pasur përqendrim tek ky tregues i performancës. Krahasimi i planifikimit dhe realizimit të humbjeve të ujit të dakorduara me KRU-të në procesin tarifor janë dhënë në tabelën 3.

Tabela 3. Vlera në përqindje e UPF: Planifikimi kundrejt realizimit (2022-2023)

Kompania	2022		2023	
	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim
KRU Prishtina	53.9%	57%	50.9%	57%
KRU Hidroregjioni Jugor	50.96%	54%	48.0%	71%
KRU Hidrodrini	56.78%	60%	54.4%	75%
KRU Mitrovica	49.03%	53%	46.6%	54%
KRU Gjakova	37.68%	48%	36.2%	48%
KRU Bifurkacioni	59.70%	51%	55.6%	46%
KRU Hidromorava	43.14%	47%	41.2%	52%
Mesatarja për sektorin	48.50%	55%	47.9%	61%

Caqet e dakorduara me KRU-të për zvogëlim të humbjeve të ujit dhe të aprovuara përmes procesit tarifor (2022-2024), përveç tek KRU 'Bifurkacioni', nuk janë arritur tek asnjëra KRU, madje tek disa KRU divergjencia është shumë e madhe midis planifikimeve dhe realizimeve.

Ky fakt ka bërë që ARRU të mendojë për një strategji të re të qasjes ndaj sfidës më të madhe të sektorit, zvogëlimit të humbjeve enorme të ujit, por edhe rreth një qasje të re ndaj KRU-ve që kanë dështuar të tregojnë rezultate të pritshme për zvogëlim të humbjeve. ARRU, për ciklin tarifor 2026-2028 do të përfshijë në metodologjinë tarifore planifikimet për zvogëlim të humbjeve të ujit; e mos përmbushja e caqeve të vendosura për humbjet e ujit do të reflektohet në uljen e tarifave. Ky veprim i ARRU-së duhet të kuptohet si një masë për shtytje të KRU-ve të angazhohen më shumë për adresimin e humbjeve shumë të larta.

Sfida për zvogëlimin e humbjeve enorme të ujit në rrjetin shpërndarës duhet ti mobilizojë të gjithë akterët e involvuar në sektorin e shërbimeve të ujit. Veprimet, para së gjithash të institucioneve, duhet të jenë të harmonizuara dhe koordinuara mirë, caqet dhe objektivat e vendosura të jenë të qarta, të arritshëm por edhe sfiduese. Për më tepër se 10 vite, raportimet për nivelin e ujit të pa-faturuar janë kamufluar, përmes raportimeve të pa sakta të prodhimit të ujit; raportimi i humbjeve në dy vitet e fundit është më i besueshëm dhe tani është shpërfaqur magnituda reale e këtij problemi. Planifikimi për zhvillimin e sektorit të shërbimeve të ujit duhet të bazohet në të dhëna të sakta të raportuara dhe të konfirmuara, përndryshe investimet jo mirë të planifikuara dhe të bazuara në të dhëna të gabuara nuk do të rezultojnë të suksesshme.

Kompanitë duhet të kenë një qasje më pro-aktive dhe strategjike për zvogëlimin e humbjeve të ujit si krijimi i strukturave (ekipeve) me kapacitete profesionale njerëzore, fokusi më i madh duhet të jetë në investime për ripërtëritjen e rrjetit në gjendje kritike, krijimin e zonave të matura të ujit (DMA), pajisjen e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës funksional, ndërmarrjen e masave për menaxhimin e presionit në rrjet, etj. ARRU kërkon me ngulm nga KRU-të të përmirësojnë urgjent sistemin e menaxhimit të dhënave, meqenëse ARRU ka shqetësime evidente në besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

2.1.9 Volumi i ujit të faturuar (shitur)

Vëllimi i ujit të shitur është faktorë i cili ka ndikim kyç në efikasitetin financiar të kompanive, sa më e lartë të jenë shitjet e ujit në raport me prodhimin, aq më të qëndrueshme financiarisht do të jenë kompanitë. Për më tepër shitjet volumetrike të ujit janë me rëndësi pasi kanë impaktin kryesor në ngarkesën tarifore. Në figurën 11 është paraqitur performanca e shitjeve volumetrike të ujit në raport me planifikimet, ashtu siç janë aprovuar përmes procesit tarifor 2022-2024.




Figura 10. përqindja e shitjeve (faturimit sasior) në raport me planin

Përveç KRU 'Bifurkacioni' që ka realizuar planifikimet e shitjeve volumetrike të ujit me 100%, asnjëra nga gjashtë KRU-të tjera nuk ka përmbushur planifikimet e shitjeve. Prej KRU-ve që nuk kanë përmbushur cakun e shitjeve, veçohen KRU Gjakova që ka ngecjen më të madhe me 18.7% dhe KRU Hidroregjioni Jugor ka ngecjen prej 16%.

Në nivel sektori shitjet e realizuara në vitin 2023, në raport me ato të planifikuara, janë përmbushur në nivel prej 91%, pra 9% nën planifikimet. Për vitin 2023 ishte planifikuar të shiten rreth 78.7 mil. m³, përderisa ishin realizuar 71.8 mil. m³ apo për 7.0 mil. m³ më pak, që tregon nivel shumë të dobët planifikues të KRU-ve.

Në nivel sektori edhe pse ka rritje të numrit të konsumatorëve në raport me vitin 2022 (rritje për 25,777 konsumatorë apo 5.9%), shitjet e ujit nuk kanë percjellur këtë trend, shitjet e realizuara janë rritur vetëm për 0.89%. Në vitin 2023 rritja e numrit të konsumatorëve ishte për 1.68% më e madhe se sa planifikimi, përderisa vëllimi i ujit të shitur ishte zvogëluar për 8.6%.

KRU	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara nga KRU-të 2023	% krahasuese 2023 / 2022	%krahasuese 2023: realizim/planifikim
PR	Uji i prodhuar	m ³	56,055,696	53,331,757	57,266,265	102.16%	107.38%
	Uji i humbur	m ³	31,897,094	27,144,201	32,628,665	102.29%	120.20%
	Uji i faturuar	m ³	24,158,602	26,187,556	24,637,600	101.98%	94.08%
	Konsumatorët	Nr	159,130	169,740	171,063	107.50%	100.78%
PZ	Uji i prodhuar	m ³	16,850,892	18,463,049	27,453,728	162.92%	148.70%
	Uji i humbur	m ³	9,046,730	8,863,634	19,382,589	214.25%	218.68%
	Uji i faturuar	m ³	7,804,162	9,599,415	8,071,139	103.42%	84.08%
	Konsumatorët	Nr	56,525	61,097	58,963	104.31%	96.51%
PE	Uji i prodhuar	m ³	24,853,142	23,726,876	38,641,481	155.48%	162.86%
	Uji i humbur	m ³	14,822,864	12,900,000	28,821,593	194.44%	223.42%
	Uji i faturuar	m ³	10,030,278	10,826,876	9,819,888	97.90%	90.70%
	Konsumatorët	Nr	55,150	55,644	57,063	103.47%	102.55%
MIT	Uji i prodhuar	m ³	27,298,408	24,512,885	27,527,413	100.84%	112.30%
	Uji i humbur	m ³	14,456,379	11,412,885	14,898,896	103.06%	130.54%
	Uji i faturuar	m ³	12,842,029	13,100,000	12,628,517	98.34%	96.40%
	Faturimi-Jug	m ³	8,231,877	8,300,000	7,742,743	94.06%	93.29%
	Faturimi-Veri	m ³	4,610,152	4,800,000	4,885,774	105.98%	101.79%
	Konsumatorët	Nr	47,679	43,464	49,635	104.10%	114.20%
GJA	Uji i prodhuar	m ³	16,177,553	15,595,903	15,726,213	97.21%	100.84%
	Uji i humbur	m ³	7,761,718	5,643,674	7,542,758	97.18%	133.65%
	Uji i faturuar	m ³	8,415,835	9,952,229	8,183,455	97.24%	82.23%
	Konsumatorët	Nr	45,807	47,534	47,631	103.98%	100.20%
FE	Uji i prodhuar	m ³	8,104,348	9,878,279	8,182,764	100.97%	82.84%
	Uji i humbur	m ³	4,128,167	5,495,400	3,793,223	91.89%	69.03%
	Uji i faturuar	m ³	3,976,181	4,382,879	4,389,541	110.40%	100.15%
	Konsumatorët	Nr	36,418	38,226	40,174	110.31%	105.10%
GJI	Uji i prodhuar	m ³	7,495,340	7,854,741	8,616,001	114.95%	109.69%
	Uji i humbur	m ³	3,494,250	3,232,781	4,486,555	128.40%	138.78%
	Uji i faturuar	m ³	4,001,090	4,621,960	4,129,446	103.21%	89.34%
	Konsumatorët	Nr	35,912	39,071	37,869	105.45%	96.92%
SEKTORI	Uji i prodhuar	m³	156,835,379	153,363,490	183,413,865	116.95%	119.59%
	Uji i humbur	m³	85,607,202	74,692,575	111,554,279	130.31%	149.35%
	Uji i faturuar	m³	71,228,177	78,670,915	71,859,586	100.89%	91.34%
	Konsumatorët	Nr	436,621	454,776	462,398	105.90%	101.68%

Tabela 4. Statistikat e disa të dhënave të realizuara dhe aprovuara 2022-2023

2.2 PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË

2.2.1 Vlera monetare e shitjeve

Vlera monetare e faturimit / shitjeve të ujit është thelbësore për KRU-të, pasi bazuar në këtë tregues, bëhen të gjitha planifikimet dhe projeksionet për shpenzimet operative dhe për investimet kapitale infrastrukturore. ARRU, bazuar në planet e biznesit të prezantuara nga KRU-të, dakordohet për vlerën e planifikuar monetare të shitjeve, arkëtimin dhe të shpenzimeve. Vlera monetare e realizuar e shitjeve të ujit është dukshëm më e ulët se sa planifikimi për të gjitha KRU-të, madje është shumë më e ulët se mos përmbushja e caktuar të planifikuar për shitjet volumetrike – referoju figurës 11.




Figura 11. Përqindja e shitjeve (faturimit në Euro) në raport me planin

Mesatarja e realizimit të shitjeve në vlerë monetare në nivel sektori për vitin 2023 ishte për 21% më e ulët se planifikimi, për më keq kjo është performancë më e dobët për 9% në raport me realizimin e shitjeve në vitin 2022.

Është për keqardhje fakti se asnjë nga KRU-të, nuk i ka realizuar objektivat e shitjeve të planifikuara në BPRR-2023, të aprovuara nga rregullatori. Në rastin më të mirë është KRU ‘Bifurkacioni’ me 88% të përmbushjes së planit, përderisa KRU ‘Gjakova’ me 69%, KRU Hidroregjioni me 76% dhe KRU Hidromorava me 78% kanë treguar rezultatet më të dobëta, por as KRU-të tjera nuk janë më mirë.

Tabela 5 paraqet shifrat statistikore të performancës së treguar për shitjet e ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU-ve me procesin tarifor për vitet 2022 dhe 2023.

Tabela 5. Vlera e shitjeve të realizuara dhe planifikuara 2022-2023

KRU	Vlera e shitjeve (Euro)						Raporti: realizimi 2023/realizimi 2022
	2022			2023			
	Planifikuar	Realizuar	raporti: realizimi/planifikimi	Planifikuar	Realizuar	raporti: realizimi/planifikimi	
PR	16,156,133	14,627,663	91%	17,450,574	14,019,707	80%	-4.16%
PZ	4,809,509	4,118,755	86%	5,387,044	4,084,655	76%	-0.83%
PE	3,875,337	3,500,927	90%	4,285,240	3,414,919	80%	-2.46%
MIT	3,957,721	3,910,897	99%	4,361,353	3,592,873	82%	-8.13%
GJA	5,002,994	3,681,970	74%	5,506,038	3,802,406	69%	3.27%
FE	2,277,452	2,073,569	91%	2,542,977	2,237,216	88%	7.89%
GJI	2,314,888	2,053,693	89%	2,577,418	2,022,290	78%	-1.53%
Sektori	38,394,034	33,967,474	88%	42,110,643	33,174,065	79%	-2.34%

Vlera e shitjeve monetare të realizuara për vitin 2023 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte rreth 33.1 mil. Euro përderisa ajo e planifikuar ishte 42.1 mil. Euro, që do të thotë rreth 9.0 mil. Euro më pak të realizuara.

Rrjedhimisht, kjo ka ndikuar në të ardhura të pa mjaftueshme nga shitjet për të përmbushur nevojat financiare të KRU-ve, në veçanti për financimin e mirëmbajtjes dhe rritjes kapitale.

Mos përmbushja e vazhdueshme e caqeve të shitjeve volumetrike dhe monetare në përgjithësi dhe individualisht për secilën KRU është tregues negativ e performancës së sektorit. KRU-ve ju mungojnë mjetet e nevojshme financiare për të siguruar qëndrueshmëri operative si dhe nivel më cilësor të shërbimeve.

Vlera relative e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2023 në raport me 2022




Figura 12. Përqindja e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2023 në raport me vitin 2022

Shitjet relative në vitin 2023 ishin më të ulëta për 2.34% se ato të realizuara në vitin 2022. Vlenë të theksohet se vetëm dy KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Gjakova' kishin realizuar vlera pozitive të shitjeve në 2023 në raport me vitin 2022.

2.2.2 Kostoja për njësi

Kostot për njësi janë analizuar përmes: kostos operative për njësi të ujit të prodhuar, kostos totale operative për njësi të ujit të prodhuar dhe kostos totale për njësi të ujit të shitur; të dhëant statistikore korresponduese për to janë dhënë në figurat në vijim:

2.2.3 Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues i rëndësishëm financiar në bazë të së cilit vlerësohen shpenzimet për 1 m³ të ujit të prodhuar.




Figura 13. Kostoja operative njësi e ujit të prodhuar (EUR/m³ të ujit të prodhuar)

Në nivel sektori shpenzimet operative për furnizim me ujë janë rritur në vlerë monetare nga 26.2 mil. Euro për vitin 2022 në 26.4 mil. Euro për vitin 2023, apo 0.7% rritje. Në këtë aspekt janë rritur edhe kostot e ujit të prodhuar. Pjesëmarrja e shpenzimeve për resurse dhe trajtim të ujit për vitin 2023 është rreth 33% nga total i shpenzimeve operative të furnizimit me ujë dhe kjo është për 2% më lartë në raport me vitin 2022.

Si mesatare e sektorit, kostot njësi të prodhimit të ujit janë rritur nga 0.048 €/m³ për vitin 2022 në 0.050 €/m³ për vitin 2023.

Kosto e ujit të prodhuar gjatë vitit 2023 variojnë nga më e ulëta 0.005 €/m³ për KRU 'Hidrodrini' deri tek ajo më e larta për KRU 'Hidromorava' me 0.078 €/m³.

Kosto dukshëm më e ulët në vitin 2023 në raport me vitin 2022 është shënuar tek KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidrodrini' edhe për faktin se në vitin 2023 nga këto dy kompani është raportuar një sasi shumë më e madhe e ujit të prodhuar.

Kostoja e prodhimit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga numri i burimeve të ujit që janë në operim dhe kapaciteti i tyre, nga lloji i burimit të furnizimit - sipërfaqësor apo nëntokësor, nga mënyra e kaptimit dhe transportit të ujit, p.sh transporti me gravitet është më i lirë se sa sistemi me pompa. Po ashtu burimet e ujit nëntokësor janë me cilësi më të mirë, që zvogëlon dukshëm koston e prodhimit, siç është rasti i KRU 'Hidrodrini' që burimet i ka me kapacitet të madh, me kualitet tejet të mirë dhe transporti realizohet kryesisht me gravitet. Në rastin tjetër të KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Hidromorava' kostoja është tejet e lartë dhe e ndikuar nga shpenzimet e larta të energjisë për operim të stacioneve të shumta pompuese, të dyja këto kompani kanë një sistem të fragmentuar të burimeve të ujit me kapacitete të vogla furnizuese, e tek KRU 'Hidromorava' shpenzimet rriten edhe për shkak të përpunimit të ujit në tre impiante.

2.2.4 Kostoja operative për njësi të ujit të shitur

Kostoja totale operative për njësi të ujit të shitur paraqet shpenzimet totale që ofruesit e shërbimeve krijojnë për furnizim të ujit tek konsumatori, e që përfshinë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale për furnizim me ujë, por duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha këto, në raport me vëllimin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Figura 14. Kostoja operative për njësi e ujit të shitur (€ për m³ ujë të shitur)

Kostoja për njësi të ujit të furnizuar në nivel të sektorit për vitin 2023 është 0.424 €/m³, që është për 0.014 €/m³ më e lartë se në vitin 2022.

Siç vërehet nga figura 14 ekziston një shpërndarje e gjerë sa i përket koston totale për njësi të ujit të shitur dhe që nuk ka të njëjtën shpërndarje sikur kostoja për njësi të ujit të prodhuar. KRU 'Hidrodrini' ka nivelin dukshëm më të ulët të koston së ujit të shitur krahasuar me të gjitha kompanitë tjera me 0.28 €/m³, deri tek ajo më e larta që është për KRU "Mitrovica" me 0.477 €/m³ dhe KRU 'Gjakova' me 0,499 €/m³. KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', që kishin koston më të lartë për njësi të ujit të prodhuar, tani radhiten me kosto më të lirë të ujit të shitur që është 0.471 €/m³ për KRU 'Hidromroava' dhe 0.465 €/m³ për KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Rritje e theksuar e koston për njësi të ujit të shitur raportohet nga KRU 'Mitrovica', nga 0.38 €/m³ sa ishte në vitin 2022 në 0.47 €/m³ për vitin 2023 – rritje prej 25.5%, si rezultat i rritjes së shpenzimeve operative për shërbimet e ujësjellësit, me theks rritja e shpenzimeve për paga të stafit. Edhe KRU 'Bifurkacioni' ka pasur rritje të koston së ujit të shitur për 16.6%, kjo rritje e koston edhe në këtë rast sërish i atribuohet kryesisht rritjes së pagave të stafit. Përderisa tek KRU 'Gjakova' rritja është shkaktuar si rezultat i rritjes së pagave, por edhe realizimit në shkallë më të lartë të investimeve kapitale të planifikuara.

2.2.5 Kostoja njësi e ujit të shitur, realizimi kundrejt planifikimit

Ky tregues paraqet raportin në mes koston për njësi të ujit të shitur në raport ndaj koston së planifikuar. Nga rezultatet e pasqyruara në fig 15 vërehet se tek shumica e KRU-ve kostoja e realizuar është më e ulët se kostoja e planifikuar, përveç tek KRU 'Hidroregjioni Jugor' që është realizuar në masën 100%, e tek KRU 'Gjakova' kostoja e realizuar është 109%, duke tejkaluar koston e planifikuar për 9%.




Figura 15. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Kostot e realizuara për njësi të ujit të shitur në raport me kostot e planifikuara në nivel të sektorit gjatë vitit 2023 ishin 89%. Kjo do të thotë se KRU-të përjashtuar KRU 'Gjakova' dhe 'Hidroregjioni Jugor' nuk kanë arritur ti realizojnë shpenzimet e planifikuara operative dhe kapitale, para së gjithash në mirëmbajtje kapitale, dhe ripërtëritje infrastrukturore. Performancë më e dobët është treguar nga KRU 'Bifurkacioni', KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Hidrodrini'. Sugjerohet që KRU-të të alokojnë dhe realizojnë shpenzimet operative, veçmas rritjen e investimeve kapitale në asete infrastrukturore (ripërtëritje e rrjetit), pasi jemi të sigurt se kjo do të sjellë përmirësim të dëshiruar në cilësinë e nivelit të shërbimit.

2.2.6 Investimet kapitale për ujësjellës

Përmes proceseve tarifore, ARRU, në baza vjetore, aprovon shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare për KRU-të dedikuar investimeve kapitale për mirëmbajtje dhe përtëritje të aseteve, e vlerësuar si e domosdoshme për të ofruar shërbime të qëndrueshme të furnizimit me ujë. Po ashtu KRU-të në planin e biznesit rregullator planifikojnë investime të konsiderueshme nga donacionet (grante nga institucionet qeveritare dhe donatorët) të cilë janë në përkrahje të sektorit.

Tabela 6. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake

KRU	Burimet vetanake të investimit				% krahasuese: 2023/2022
	2022	2023			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim/planifikim	
PR	525,526	1,493,660	701,478	47.0%	33%
PZ	594,062	765,214	493,986	64.6%	-17%
PE	381,219	1,014,509	409,285	40.3%	7%
MIT	5246	456,669	79,148	17.3%	1508%
GJA	600,850	1,145,646	915,233	79.9%	52%
FE	83,256	365,324	148,353	40.6%	78%
GJI	133,123	392,888	170,908	43.5%	28%
Sektori	2,323,282	5,633,910	2,918,390	51.8%	26%

Në vitin 2023 përmes procesit tarifor në total ishin aprovuar në nivel sektori rreth 5.6 mil. € për kostot kapitale në shërbimin e furnizimit me ujë dhe ishin më tepër për 0.6 mil. € se në vitin 2022. Janë realizuar rreth 2.9 mil. € apo 51% nga ajo që ishte aprovuar.

Përqindjen me të lartë të investimeve kapitale nga burimet vetanake, në raport me planin në vitin 2023, e ka realizuar KRU 'Gjakova' me 79%, e pasuar nga KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 64.6%. Të gjitha KRU-të tjera kanë realizuar më pak se 50%-shin e investimeve kapitale të aprovuara me proces tarifor. Është për t'u theksuar se krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të realizimit të investimeve kapitale. Përqindja shumë e lartë krahasuese: 2023/2022 (realizim) për KRU 'Mitrovica' është se në vitin 2022 ka pasur një shumë modeste të investuar.

Mungesa e investimeve, sidomos e atyre të dedikuara për mirëmbajtje dhe ripërtëritje kapitale, padyshim se rezulton me përkeqësim të bazës së aseteve dhe rënie të nivelit të shërbimit, me trend në rritje të defekteve në rrjet si dhe nivel të lartë të humbjeve të ujit në sistemin shpërndarës.

Tabela 7. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

KRU	Investimet prej granteve			
	2022	2023		
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim/ planifikim
PR	147,266	0	115,197	/
PZ	136,918	13,639,195	324,400	2.4%
PE	0	0	0	0.0%
MIT	410	0	1,916,121	/
GJA	104,996	19,888,000	446,653	2.2%
FE	360	714,278	1,707,022	239.0%
GJI	76,847	4,215,410.4	843,376	20.0%
Sektori	466,797	38,456,883	5,352,769	13.9%

Shuma monetare në vlerë prej 38.4 mil. Euro ishte planifikuar të sigurohet dhe të investohet prej granteve nga donatorë për vitin 2023. Nga kjo shumë janë realizuar rreth 5.3 mil. Euro apo 13.9%, që në raport me vitin 2022 është më tepër se 10 fish më e lartë. Shumica e vlerës së investimeve nga grantet ishin paraparë nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', KRU 'Gjakova' dhe KRU 'Hidromorava', përderisa realizimi ishte shumë më i ulët se planifikimi.

Për vitin 2023, KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica' nuk kishin planifikime të investimeve nga donatorët. KRU 'Hidrodrini' nuk kishte ndonjë vlerë të realizuar, ndërsa KRU 'Mitrovica' ka realizuar rreth 1.9 mil. Euro.

Tabela 8. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

	Burimet vetanake të investimit + grantet			
	2022	2023		
	Investimet kapitale (realizim)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim/ planifikim
Sektori-InvVet	2,323,282	5,633,910	2,918,390	51.80%
Sektori-Grant	466,797	38,456,883	5,352,769	13.92%
Sektori	2,790,079	44,090,793	8,271,159	18.76%

Nga tabela 8 vërehet se realizimi i investimeve kapitale në vitin 2023, në nivel sektori nga mjetet vetanake dhe donacionet ishte rreth 8.3 mil. Euro.




Figura 16. Shpenzimet kapitale të realizuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

Nga totali i investimeve kapitale (vetanake dhe grante) në shërbimin e furnizimit me ujë si mesatare e sektorit janë realizuar 18.8%. Më shumë investime janë realizuar nga KRU 'Mitrovica', për faktin se planifikimet nga grantet ishin 0 Euro, e kjo ka bërë që realizimi të kapërcejë shumëfish planifikimet. KRU 'Bifurkacioni' po ashtu ka tejkaluar planifikimet për sa i përket investimeve nga grantet për 240%, ndërsa si shumë kumulative e investimeve nga financat vetanake dhe granteve ka tejkaluar planifikimet për 172%. Të gjitha KRU-të tjera kanë ngecur në përmbushjen e planifikimeve.

2.3 PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

2.3.1 Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Viteve të fundit trajtimi i ujërave të ndotura është bërë prioritet i investimeve të institucioneve vendore dhe donatorëve ndërkombëtar. Në fund të vitit 2023, në mbarë Kosovën, janë në funksion 7 impiante të trajtimit të ujërave të ndotur, të cilat janë nën menaxhimin e KRU-ve. Këto shtatë impiante trajtojnë ujërat e ndotura të vend-banimeve vijuese: ITUN në Skënderaj trajton ujërat e ndotur të vendbanimeve Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Tërnavc dhe menaxhohet nga KRU Mitrovica, ITUN në Mramor dhe Harilaç për këto 2 vendbanime të menaxhuara nga KRU Prishtina, ITUN në Prizren për një pjesë të zonës urbane të qytetit të Prizrenit e menaxhuar nga KRU Hidroregjioni Jugor, ITUN në Pejë për një pjesë të zonës urbane e qytetit të Pejës dhe vendbanimit Qyshk e menaxhuar nga KRU Hidrodrini, dhe ITUN në Gjakovë për një pjesë të zonës urbane të qytetit të Gjakovës e menaxhuar nga KRU Gjakova.

Në kuadër të ITUN janë ndërtuar laboratore, të pajisura me pajisje moderne dhe staf të trajnuar, por që këto laboratore ende nuk janë të akredituar nga agjencioni përgjegjës vendor. Rekomandohet tek agjencionet projekt zbatuese/ donatorët që financojnë ndërtimin e laboratorëve të kryejnë edhe akreditimin e laboratorëve dhe certifikimin e personelit.

Rezultatet e analizave/testimeve laboratorike që kryhen në këto laboratore, janë raportuar se janë brenda standardeve të kërkuara vendore, përjashtuar ato të raportuara nga KRU 'Hidrodrini' e cila nga 2,636 teste të bëra gjatë vitit 2023, 50 sosh nuk kanë qenë në përputhje me vlerat e lejuara të standardeve respektive.

2.3.2 Shpeshësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit

Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit tregon performancën operative të sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura.




Figura 17. Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Numri i lartë i bllokimeve duhet të merret me rezervë, meqë shumica e KRU-ve nuk kanë të digjitalizuar tërë rrjetin e kanalizimit, kurse raportimet për bllokimet raportohen vetëm për pjesën e rrjetit të kanalizimit të digjitalizuar. Gjatësia reale e rrjetit të kanalizimit është shumë herë më e madhe se sa gjatësia e rrjetit të digjitalizuar në sistemin GIS.

Në anën tjetër, menaxhimi i të dhënave për bllokimin dhe dështimin e rrjetit të kanalizimit nuk është i kënaqshëm meqenëse asnjëra nga kompanitë nuk kanë qenë azhure në përditësimin e të dhënave në modulet softuerike respektive.

2.3.3 Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindje e popullsisë, brenda zonës së shërbimit, që kanë shërbime të kanalizimit nga KRU.




Figura - 18 Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura

Gjatë vitit 2023 mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi) në nivel sektori ka shënuar një progres të vogël, mbulueshmëria është rritur për 1% krahasuar me vitin paraprak dhe ka arritur në nivelin 66%.

Në nivel individual të KRU-ve gjendja ka mbetur e njëjtë në këto dy vite, me përjashtim të KRU 'Hidromorava' e cila ka shënuar progres për 2% tek ky tregues. KRU 'Hidrodrini' me 45% dhe KRU 'Hidromorava' me 52% janë dy regjionet me nivelin më të ultë të shtrirjes së shërbimit të ujërave të ndotura (sistemeve që menaxhohen nga KRU-të).

Trajtimi i ujërave të ndotura nga KRU-të mbetet ende i ulët me vetëm 8.1% të pjesëmarrjes së popullatës që janë të kyçur në impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura, ndërsa raporti midis vëllimit të përgjithshëm të ujërave të ndotur të grumbulluar (dhe faturuar) ndaj vëllimit të ujit të trajtuar në ITUN është 25%. Kjo për arsye të një shkalle tejet të lartë të infiltrimit të ujërave nëntokësore dhe me gjasë e depërtimit të ujërave sipërfaqësor në rrjetin e kanalizimit.

2.3.4 Ankesat për shërbimet e ujërave të ndotur

Treguesi në vijim, paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i adresojnë tek kompanitë e tyre, në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura.

Në këtë pjesë janë përfshirë ankesat e natyrës teknike, përderisa për ankesat komerciale adresuar tek KRU janë përmbledhur për të dyja shërbimet, furnizim me ujësjellës dhe ujëra të ndotura, janë trajtuar në pjesën 2.1.4, Ankesat e konsumatorëve.

Tabela 9. Ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura²

KRU	Ankesat teknike	
	2022	2023
PR	3,815	3,269
PZ	1,479	561
PE	241	3,092
MIT	620	3,453
GJA	0	553
FE	28	966
GJI	2	703
Sektori	6,185	12,597

Numri i lartë i ankesave për aspektet teknike janë shumë më të larta se në vitin 2023 (më shumë se 50%), na jep të kuptojmë se ka shumë probleme teknike edhe në këtë shërbim.

Numri i lartë i ankesave për aspektet teknike janë tek KRU ‘Mitrovica’, ‘Hidrodrini’ etj. Njëjtë sikur tek uji i pijes, menaxhimi i ankesave në disa KRU, duhet dhe mëtej të përmirësohet, për këtë arsye ka edhe diferenca të mëdha në numrin e ankesave të vitit 2022 dhe 2023. Të dhënat tek ky tregues janë me besueshmëri më të ulët.

Sugjerojmë që KRU-të të jenë më të përgjegjshme në regjistrimin dhe mirëmbajtjen e databazës së ankesave për ujërat e ndotur, t’i funksionalizojnë aplikacionet softuerike (CRM) në mënyrë që edhe ankesat e konsumatorëve në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura të azhurnohen dhe përditësohen vazhdimisht.

² Referenca: Të dhënat statistikore në Tab. 9, janë të raportuar/ inspektuar sipas formatit –Moduli i standardeve të shërbimit

2.4 PERFORMANCA FINANCIARE-SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.4.1 Faturimi (shitjet) volumetrike të shërbimeve të ujërave të ndotura

Duke marrë parasysh se faturimi (shitjet) volumetrike të shërbimeve të ujit ishin nën vlerën e planifikuar, rrjedhimisht edhe vlera volumetrike e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të ndotura është nën vlerat e planifikuara të shitjeve, pasi ngarkesa volumetrike e konsumatorëve për ujëra të ndotur bazohet në ngarkesën volumetrike për ujë, në rastet kur konsumatorëve u ofrohen dy shërbimet.




Figura 19. Shitjet volumetrike të ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Në vitin raportues 2023 asnjëra nga KRU-të nuk ka arritur caqet e shitjeve të ujërave të ndotura. Në mesatare shitjet janë për 19% më të ulëta nga planifikimet, dhe për 12% më të ulëta se sa në vitin 2022.

Edhe në vitin 2023 performancë më të mirë në arritjen e cakut të shitjeve është realizuar nga KRU 'Bifurkacioni' me 98% përaftrim tek caku, gjersa KRU-të tjera kanë dështuar të përmbushin cakun në përqindje më të lartë.

2.4.2 Vlera monetare e realizuar e faturimit (shitjeve) të shërbimit të ujërave të ndotura

Vlera monetare e shitjeve të ujërave të ndotura ka impakt të rëndësishëm në gjendjen financiare të KRU-ve. Shitjet monetare për shërbimet e ujërave të ndotura në terma real ishin më të ulëta se sa në vitin 2022.




Figura 20. Vlera monetare e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotur gjatë 2023 në raport me 2022

Shuma totale e shitjeve në vlerë monetare në vitin 2023 ka rënë në 6.4 mil. Euro nga 6.5 mil. Euro apo për -2.64% më pak.

Devijim më i madh nga caku dhe të hyra më të ulëta për 16.86% në vitin 2023 ishin realizuar nga KRU 'Mitrovica', kryesisht për shkak të faturimit më të ulët volumetrik për shërbimet e ujit.

2.4.3 Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Ky tregues nënkupton shpenzimet totale operative për shërbimet e ujëra të ndotura, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të ndotura në raport me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak për vit.




Figura 21. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura (euro/konsumatorë/vit)

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale për konsumatorët shtëpiak të shërbyer³.

Kostot për njësi për vitin 2023 dhe 2022 janë të paraqitura në figurën 21. Këto kosto për njësi janë shumë të ulëta në krahasim me kostot e shërbimeve të ujërave të ndotura në shumë prej ekonomive të tjera perëndimore, kryesisht për shkak të faktit se nuk ka shpenzime të trajtimit, përjashtuar KRU 'Hidoregjonin Jugor' KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Gjakova" të cilat kanë filluar me këtë shërbim. Kostoja mesatare për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2023 ka treguar rritje nga 9.97 euro/konsumatorë/vit në 12.60 euro/konsumatorë/vit. Ky trend rritës i atribuohet rritjeve të shpenzimeve totale për ujëra të ndotura si rezultat i përpunimit të ujërave të ndotur në regjionet e sipër përmendura.

2.4.4 Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Me procesin tarifor për vitin 2023, ARRU ka aprovuar investime kapitale (mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale) me qëllim KRU të sigurojnë nivele më të kënaqshme të shërbimit të ujërave të ndotura.

³Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohehen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

Tabela 10. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake

Burimet vetanake të investimit				
KRU	2022	2023		
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim / planifikim
PR	190,957	266,976	44,334	16.6%
PZ	6,360	230,677	1,321	0.6%
PE	13,494	58,547	112,348	191.9%
MIT	119	175,642	4,710	2.7%
GJA	2,806	243,440	15,264	6.3%
FE	14,461	152,223	16,179	10.6%
GJI	8,797	135,961	109,669	80.7%
Sektori	236,994	1,263,466	303,826	24.0%

KRU-të në total nga mjetet e vatanake, kishin planifikuar investime në shërbimin e ujërave të ndotura rreth 1.3 mil. Euro, përderisa ishin realizuar vetëm 24% të tyre. Investimet kapitale të realizuara në vitin 2023 në infrastrukturën e ujërave të ndotur janë rreth 0.303 mil. Euro, që është për 4% më e lartë se në vitin 2022, por është shumë modeste krahasuar me gjendjen dhe nevojat në këtë sektor. Cakun e investimeve e ka përbushur vetëm KRU 'Hidrodrini', kjo për faktin sepse vlera e planifikuar për investime ka qenë shumë modeste. Të gjitha KRU-të kanë dështuar të përbushin shumën e planifikuar të investimeve dhe ARRU është shumë e brengosur me këtë trend.

Tabela 11. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

Investimet prej granteve				
KRU	2022	2023		
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim / planifikim
PR	510,405	63,406,798	0	-
PZ	43,713	9,890,992	0	0.0%
PE	0	0	2,290,017	-
MIT	41	0	0	/
GJA	23	2,341,895	15,366,066	656.1%
FE	90	0	0	-
GJI	0	0	0	-
Sektori	554,272	75,639,685	17,656,083	23.3%

Kompanitë për vitin 2023 kishin planifikuar investime nga grantet (qoftë investime nga institucionet qeveritare apo donatorët) në shumë prej 75.6 mil. Euro. Nga kjo shumë janë realizuar vetëm 17.6 mil. Euro, gjegjësisht 23.3%, që kryesisht janë investime të realizuara nga KRU 'Gjakova' dhe KRU 'Hidrodrini', të lidhura me ndërtimin e ITUN.

Tabela 12. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

	Burimet vetanake të investimit + grantet			
	2022	2023		
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2023: realizim/ planifikim
Sektori-InvVet	236,994	1,263,466	303,826	24.0%
Sektori-Grant	554,272	75,639,685	17,656,083	23,3%
Total Sektori	791,265	76,903,151	17,959,908	23.4%

Në total në sektorin e shërbimeve të ujërave të ndotura, nga mjetet e planifikuara të investohen nga KRU-të, por edhe nga grantet ishin realizuar 23.4% investime të projektuar nga vitet e kaluar.




Figura 22. Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planifikimin; shuma e investimeve vetanake dhe donacioneve

ARRU pret nga KRU-të që të bëjnë planifikime më reale të investimeve, si në vlerë monetare po edhe në afatet kohore të kryerjes së investimeve. Praktika e planifikimeve pa një siguri të lartë se investimet e propozuara do të realizohen duhet të ndërpritet.

2.5 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E OFRUESVE TË SHËRBIMIT

2.5.1 Arkëtimi i të ardhurave

Arkëtimi i të hyrave paraqet raportin e mbledhjes së keshit ndaj faturimit / shitjeve të shërbimeve të ujit gjatë vitit raportues dhe paraqet njërin prej treguesve me domethënës; krahas efijencës së faturimit ka impakt të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimit.




Figura 23. Shkalla e arkëtimit

Në vitin 2023 nga shtatë KRU janë arkëtuar rreth 40.5 mil. Euro, ka një përmirësim për rreth 3.0 mil. Euro në vlerë monetare apo shprehur në përqindje afër 10 % përmirësim në raport me vitin paraprak. Përndryshe keshi i arkëtuar ndaj faturimit për vitin 2023 është 102%, apo rreth 1.0 mil. Euro mbi vlerën monetare të faturimit vjetor. Kjo do të thotë se KRU-të kanë arkëtuar edhe një shumë të konsiderueshme të mjeteve nga borxhet e viteve paraprake.

KRU 'Hidromorava' me 110% të arkëtimit, pastaj KRU Prishtina', KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Mitrovica' të gjitha me 105%, KRU 'Gjakova' me 104% dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' me realizim 100% të arkëtimit ishin përfomuesit më të mirë gjatë vitit 2023, pasi arritën një efijencë të lartë në shkallën e arkëtimit. Ngecje në përmirësim të arkëtimit edhe gjatë vitit 2023 ka shënuar KRU 'Hidrodrini' me vetëm 84% të mbledhjes së keshit, që është një përkeqësim për 5% në raport me vitin paraprak.

Një analizë e performancës së arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve është prezantuar në tabelën 13.

Tabela 13. Shkalla e arkëtimit e realizuar

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Amvisëri	87%	106%	95%	101%	87%	87%	74%	100%	102%	105%	84%	100%	100%	114%
Komercial-industrial	97%	106%	105%	98%	92%	81%	100%	110%	115%	97%	149%	102%	101%	98%
Institucione	104%	101%	107%	94%	94%	73%	85%	145%	104%	111%	119%	195%	102%	96%
Mesatarja	90%	105%	98%	100%	89%	84%	78%	105%	108%	104%	96%	105%	101%	110%

Në vitin 2023 ka përmirësim të arkëtimit të keshit prej kategorisë së konsumatorëve shtëpiak, pothuaj tek të gjitha KRU-të, të cilët tradicionalisht kanë qenë paguesit më të pakët të shërbimeve.

Përmirësimet në arkëtim janë evidente edhe tek kategorit e konsumatorëve tjerë, përveç KRU 'Hidrodrini' që ka rënie të dukshme të arkëtimit tek këto dy kategori të konsumatorëve.

Kompanitë duhet të synojnë mbledhjen e të hyrave nga konsumatorët e amvisërisë meqenëse rreth 70% e të hyrave të KRU-ve sigurohen prej tyre, pa nënvlerësuar arkëtimin nga dy kategorit e tjera të konsumatorëve. Kjo shkallë e kënaqshme e arkëtimit e realizuar duhet të mirëmbahet përmes përmirësimit të vazhdueshëm të nivelit të shërbimeve dhe rritjes së kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet që ofrohen. Krahas mbledhjes së borxheve të vjetra, rekomandohet që KRU-të, për mirëmbajtje të qëndrueshmërisë financiare dhe rrjedhjes së parasë, të fokusohen në përmirësimin e praktikave të arkëtimit të borxheve aktuale, për shkak të kufizimeve kohore dhe ligjore për arkëtim të borxheve të vjetra dhe nevojës së angazhimit të palëve të treta (përmbauesve) për arkëtim të borxhit të vjetër.


Tabela 14. Shkalla e arkëtimit e realizuar dhe e planifikuar për vitet 2022 dhe 2023

Shkalla e arkëtimit	2022		2023	
	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar
KRU				
PR	90%	94%	105%	94%
PZ	98%	94%	100%	94%
PE	89%	94%	84%	94%
MIT	78%	86%	105%	88%
GJA	108%	95%	104%	95%
FE	96%	93%	105%	93%
GJI	101%	94%	110%	94%
Sektori	92%	93%	102%	93%

Objektivat e planifikuara për normën e arkëtimit për vitin 2022 dhe 2023 janë përbushur nga të gjitha KRU-të.

2.5.2 Kthimi ne kapital

Kostoja e kapitalit është një zë i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit të ujit, si e tillë ka impakt të rëndësishëm në ngarkesën tarifore, si tregues paraqet ndryshimin në mes të **ardhurave vjetore, shpenzimeve operative, mirëmbajtjen kapitale dhe të ardhurave të shlyera të cilat qëndrojnë në raport me bazën rregullatore të aseteve (BRR)**⁴, për procesin aktual tarifor 2022-2024, vlera e kthimit në bazën rregullatore të aseteve e aprovuar nga ARRU është 4%.



⁴Për më shumë detaje mbi bazen rregullatore te aseteve mund ti gjeni në 'Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU'.

Figura 24. Kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BRR)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit edhe në vitin 2023, ka qenë me trend pozitiv 5.10%, ndonëse në raport me vitin 2022 ka shënuar normë më të ultë. Me rritjen e efikasitetit të arkëtimit si dhe me një program të zvogëlimit të shpenzimeve operative, KRU-të me siguri do të kishin pasur mundësi më të mira për investime të konsiderueshme në asetet infrastrukturore. Si do që të jetë edhe në vitin 2023, shumica e KRU-ve, kanë arritur ti mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRR, brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

Në aspektin individual KRU 'Mitrovica' edhe në vitin 2023 ka pasur trend negativ me -10.4%, në raport me nivelin e planifikuar të kthimit në kapital, në anën tjetër KRU 'Bifurkacioni' ka performuar pozitivisht me nivel 8%, duke mbajtur nivel të qëndrueshëm të kthimit në kapital për dy vite radhazi (2022-2023).

2.5.3 Shpenzimet operative

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar kostot operative të shtatë (7) ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë, për periudhën dy vjeçare aktuale 2023, krahasuar me vitin 2022.

Shpenzimet operative i referohen kostove të KRU-ve të domosdoshme për funksionimin, operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, siç janë: shpenzimet e personelit, energjia elektrike, derivatet, kemikaliet së bashku me kostot e tjera administrative të lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në tabelën 15, janë dhënë statistika të përmbledhura të shpenzimeve të përgjithshme për shërbimet e ujit të planifikuara si dhe ato të realizuara për vitin 2023 dhe 2022, në nivel sektori dhe specifikisht për secilën KRU, në vlera nominale por edhe të rregulluara për shkallën respektive të inflacionit.

Tabela 15. Vlera e shpenzimeve operative të realizuara dhe planifikuara

Shpenzimet operative	Realizimi			Planifikimi		
	2022 pa inflacion	2022 ⁵ me inflacion	2023 pa inflacion	2022 me inflacion	2023 ⁶ me inflacion	2023 pa inflacion
KRU						
PR	10,784,853	11,317,429	11,714,925	12,928,722	13,757,497	11,749,032
PZ	4,081,718	4,283,281	4,644,903	5,411,703	5,533,377	4,725,555
PE	3,104,474	3,257,779	3,477,463	3,693,448	3,876,913	3,310,920
MIT	3,635,502	3,815,030	4,038,928	4,121,397	4,457,638	3,806,865
GJA	3,901,794	4,094,472	3,824,109	4,966,029	4,978,472	4,251,662
FE	1,579,546	1,657,547	2,146,347	2,280,662	2,293,683	1,958,826
GJI	1,785,009	1,873,156	2,078,121	2,184,777	2,192,232	1,872,187
Spektori	28,872,896	30,298,694	31,924,795	35,586,739	37,089,812	31,675,047

Në vitin 2023 për shtatë KRU-të, me proces tarifor, janë aprovuar rreth 31.6 mil. Euro shpenzime operative, e nga kjo shumë janë realizuar 31.9 mil. Euro. Që do të thotë se KRU-të kanë realizuar pjesën e shpenzimeve në nivelin 100.7% (pa inflacion), poshtu shpenzimet në vlera nominale në vitin 2023 ishin më të larta për 3.05 mil. Euro apo në normë 10 %, në raport me vitin 2022.

Shpenzimet operative për furnizim me ujë janë rritur 0.7%, përderisa në shërbimin e ujërave të ndotura shpenzimet operative ishin më të larta për 26.2%. Tek furnizimi me ujë një rritje më e theksuar e shpenzimeve operative është raportuar nga KRU 'Bifurkacioni', ku ka pas rritje të shpenzimet e prodhimit të ujit.

⁵ Shpenzimet operative të realizuara për vitin 2022 janë të llogaritura, me inflacion 1.05 përderisa ato të vitit aktual janë me 1

⁶ Shpenzimet operative të planifikuara për vitin 2022 dhe 2023 janë të llogaritura me inflacion 1.17




Figura 25. Pjesëmarrja e kategorive të shpenzimeve operative për vitin 2022 dhe 2023

Shpenzimet për personelin dhe energjinë në vitin 2023 për KRU-të në nivel sektori së bashku përbënin 79.5%, (në raport me totalin e shpenzimeve) e të cilat janë për 1.5% më të larta se në vitin 2022 dhe kanë ndikuar esencialisht në efikasitetin e KRU-ve.

Shpenzime operative me te larta në kategorinë e pagave në raport me totalin e shpenzimeve janë raportuar tek KRU ‘Bifurkacioni’ me pjesëmarrje prej 77%, tek KRU ‘Gjakova’ me pjesëmarrje prej 72% dhe KRU ‘Hidromorava’ me pjesëmarrje prej 70%, që është praktikë tejte e keqe.

Në bazë të analizave janë identifikuar shpenzime më të larta për paga, energji, dhe mirëmbajtje & riparime, përderisa shpenzime më të ulta ishin realizuar për derivate dhe shërbime të kontraktuara. Për sa i përket shpenzimeve të energjisë KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Prishtina' kanë përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes së kësaj kategorie të shpenzimeve, me 22% nga totali i shpenzimeve.

Reduktimi dhe menaxhimi i shpenzimeve operative në mënyrë efektive është esencial dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përfitimin financiar të kompanisë. Para se gjithash KRU-të duhet të kenë parasyshë racionalizimin e kostove të personelit: rritjen e efikasitetit të stafit, zvogëlimin e UPF, përmirësimin i efijencës së energjisë etj.

2.5.4 Efikasiteti i stafit

Efikasiteti i stafit është tregues tipik menaxherial dhe tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt të angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura për t'ju shërbyer 1000 konsumatorëve.




Figura 26. Efikasiteti i stafit

Në vitin 2023, nuk ka ndonjë ndryshim në rangimin e KRU-ve sipas efikasitetit të stafit, e në nivel sektori ka një përmirësim minor. Kompanitë gjatë vitit 2023 ofruan një raport mesatar prej 4.57 staf për 1,000 konsumatorë nga 4.59 sa ishte në vitin 2022. Ky përmirësim i efikasitetit të stafit vazhdon të jetë për shkakun e rritjes më të madhe të numrit të konsumatorëve, përkatësisht ndërtimit të objekteve shumëkatëshe me shumë apartamente, ku një pronar zotëron më tepër njësi banimi ose prona, e të gjithë në bazën e konsumatorëve regjistrohen si konsumatorë të rinjë; pra nuk bëhet fjalë për zgjerim të zonës së shërbimit. Ky konkludim përforcohet me numër të lartë të konsumatorëve që faturohen vetëm me taksë fikse, e që nuk kanë ngarkesë volumetrike, e besohet që kjo kategori merr pjesë me përqindje të konsiderueshme. Gjatë vitit 2023 numri i konsumatorëve të shërbyer është rritur për 22,715 apo për 5.2%.

KRU 'Bifurkacioni', KRU 'Mitrovica', KRU Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Gjakova' kanë efikasitet më të dobët të stafit për 1,000 konsumatorë dhe radhiten mbi mesataren e sektorit që ka një vlerë mesatare të koeficientit të efikasitetit të stafit prej 4.56, e që mund të konsiderohet në nivel të pranueshëm për nivelin e automatizimit të proceseve nëpër impiantet e përpunimit të ujit dhe ujërave të ndotura.

Në anën tjetër planifikimi dhe realizimi i këtij treguesi të performancës është treguar në tabelën 16.

Tabela 16. Efikasiteti i realizuar dhe ai i planifikuar për vitin 2023

Efikasiteti i stafit	Realizimi	Planifikimi
KRU	2023	2023
PR	3.6	3.6
PZ	5.4	6.4
PE	4.6	4.8
MIT	5.3	5.7
GJA	6.1	6.7
FE	5.0	6.4
GJI	4.5	4.2

Kompanitë edhe në këtë tregues kanë propozuar caqe sfiduese, të cilat janë përmbushur ose mbajtur në nivel të kënaqshëm nga të gjitha KRU-të, me theks të veçantë ka pasur përmirësime tek KRU 'Bifurkacioni', KRU 'Gjakova' dhe KRU 'Hidroregjioni', megjithëse këto tri kompani ende janë mbi nivelin e mesatares së sektorit.

3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NPH 'Ibër Lepenci', e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina'.

Në vazhdim, në formë tabelare janë dhënë statistikat për disa tregues të performancës për trendet e zhvillimit të performancës në vitin 2023 në raport me vitin 2022.

Tabela 17. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2023 / 2022	2022	2023
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	48,572,799	45,544,034
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,451,789	1,319,454
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,417,694	1,451,255
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	1,907,045	2,156,148
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	73	63

Në vitin 2023 nga NPH 'Ibër Lepenci' janë faturuar / shitur rreth 45.5 mil. m³ kjo është për 6.0 % më pak se në vitin 2022. Nga ky vëllim për KRU 'Mitrovica' janë faturuar rreth 28.1 mil. m³, apo 62% si dhe për KRU 'Prishtina' janë faturuar rreth 17.4 mil. m³ apo 38%. Faturimi në vlerë monetare për ujin me shumicë po ashtu ka shënuar rënie për 9%, i ndikuar nga zvogëlimi i faturimit volumetrik.

Tabela 18. Treguesit e performancës së NPH 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2022	2023
Shkalla e arkëtimit	98%	110%
Norma e punës	0.76	0.61
Norma e mbulimit të punës	0.74	0.67
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.039	0.047

Në tabelën 18 është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të të cilëve mund të vlerësohet performanca e NPH 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2023/2022.

NPH 'Ibër Lepenci' ka arritur normën e shkallës së arkëtimit në nivel prej 110% në vlerë monetare për shkak të arkëtimit të borxheve të vjetra.

Shpenzimet operative për furnizimin e ujit me shumicë janë rritur për një vlerë të konsideushme dhe kjo ka bërë që edhe në raport me mbledhjen e keshit, 'norma e mbulimit të punës', të jetë më e ulët.

4. BESUESHMËRIA DHE SAKTËSIA E TË DHËNAVE

Mbledhja dhe analizimi i besueshmërisë së të dhënave për ARRU-në është një mekanizëm i rëndësishëm në zhvillimin / ndërtimin e shërbimeve të qëndrueshme të ujit për të gjithë konsumatorët. Procesi i raportimit të dhënave nga KRU-të, bëhet përmes formateve të specifikuar periodike/vjetore ku përfshihen të dhënat operative, financiare dhe atyre të shërbimeve ndaj konsumatorëve ndërsa auditohen/verifikohen në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë nga ARRU në baza vjetore. Për fat të keq, të dhënat e raportuara nga KRU-të ende nuk janë në nivelin e kënaqshëm të besueshmërisë dhe saktësisë. Nisur nga arsyet e tilla, ARRU ka kërkuar nga KRU-të, të instalojnë ujëmatës funksional në të gjitha vendburimet / pikat e trajtimit të ujit, të avancojnë sistemet e tyre të mbajtjes dhe menaxhimit të dhënave por edhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të avancuar metodologjinë e vet të vlerësimit të besueshmërisë dhe saktësisë së të dhënave.

ARRU nga viti 2018 ka hartuar dhe zbatuar Udhëzuesin, “Avancimi i sistemit të monitorimit në ARRU dhe 7 KRU”, ky ka qenë një hap i rëndësishëm, ndonëse modest, në aspektin e kriterëve dhe kategorizimit të besueshmërisë, kryesisht i bazuar në zhvillimin e sistemeve adekuate elektronike të ruajtjes dhe menaxhimit të informacioneve. Në aspektin e besueshmërisë dhe saktësisë, të dhënat janë vlerësuar në 3 kategori, të specifikuar me nota-norma korresponduese: (i) të besueshme - 100%, (ii) pjesërisht të besueshme - 50% si dhe (iii) jo të besueshme – 0%.

Në vitin 2022, edhe njëherë është shqyrtuar dhe vlerësuar nga ARRU, sistemi i verifikimit të të dhënave dhe si rezultat i tij është hartuar “MODULI I BESUESHMËRISË SË TË DHËNAVE - 2023”, ku të dhënat janë vlerësuar në kontekst të besueshmërisë, në më shumë aspekte dhe kriterë si: sistemi i mbajtjes së shënimeve, përditësimi i të dhënave, efikasiteti i përpunimit dhe gjenerimit të raporteve të kërkuara, paisjeve matëse, procedurave të zbatuara në lidhje me mbledhjen dhe trajtimin e tyre, etj.

Në aspektin e besueshmërisë dhe saktësisë, të dhënat janë vlerësuar në 5 kategori, të specifikuar me nota-norma korresponduese:

(i) nota 5 = 100%, (ii) nota 4 = 76%-90%, (iii) nota 3 = 51%-75%, (iv) nota 2 = 26%-50% si dhe (v) nota 1 = 0%-25%.

Nota 1 - (0%-25%) tregon besueshmërinë më të ulët, përderisa nota 5 - (100%) tregon besueshmërinë më të lartë.

Përfundimet e nxjerra nga analiza e sistemit të informacioneve të KRU-ve, në kontekst të saktësisë, mundësisë së gjenerimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme, janë paraqitur në pjesën e më poshtme, si në vijim së bashku me një tabelë, me statistika për të dhënat e raportuara në vitin 2023.

Në përgjithësi vlera përfundimtare mesatare e besueshmërisë në tërë grupin e të dhënave për KRU-të , sillet nga më e ulta (74%) tek KRU ‘Hidrodrini’ deri te ajo më e larta (83%) tek KRU ‘Hidromorava’.

Përndryshe të dhënat e gjetura në përgjithësi janë të sakta në raport me ato të cilat kompania i ka raportuar, me disa ndryshime të evidentuara si pasojë e mos qartësisë së definicionit të të dhënave nga ana e zyrtarëve respektiv. Në përgjithësi kompanitë ende nuk e kanë një sistem të mirëfilltë të menaxhimit të informacioneve, ngecje ka në pjesën e menaxhimit të të dhënave operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, megjithëse sistemi në disa pjesë është në zhvillim e sipër si: GIS, SCADA në ITU, CRM (Modulet e mirëmbajtjes dhe ankesave), etj.

Në vazhdim në mënyrë të përmbledhur, janë dhënë komente në lidhje me besueshmërinë aktuale të disa të dhënave të cilat kërkojnë përmirësim më të shpejtë. Për më tepër, më shumë detaje për secilën të dhënë / grupim të dhënash në mënyrë specifike, janë dhënë në Raportet individuale “Auditimi/Verifikimi i të dhënave të raportuara -2023’ për secilën KRU.

Presioni i ujit: Kjo e dhënë dhe në përgjithësi monitorimi i presionit është me besueshmëri të ulët. Për monitorim të presionit janë vendosur një numër i kufizuar i manometrave në pjesë të caktuara të

zonës së shërbimit, por të dhënat nuk mund të sigurohen për pjesën dërmuese të zonës së shërbimit; për të gjitha KRU-të situata është e njëjtë. Përndryshe leximi i manometrave dhe evidenca e rregullt e presionit në rrjetin e ujësjellësit në kohë reale, bëhet vetëm në një numër të kufizuar të DMA-ve. Nuk është bërë ndarja zonale dhe modeli hidraulik i presionit të zonës së shërbimit në asnjërin nga KRU-të. Një vlerësim i presionit mesatar bëhet përmes testimeve fizike të herë pas hershme. Në situatë më të mirë në këtë aspekt është KRU 'Gjakova' e cila ka një numër të konsiderueshëm të manometrave të vendosur në kuadër të stacioneve të pompimit të ujit, si dhe në rrjetin shpërndarës, për të cilin mbahet edhe një evidencë më e rregullt.

Uji i prodhuar: Të dhënat për ujin e prodhuar janë kyçe me ndikim në shumë tregues të performancës. Për vitin 2023 kjo e dhënë nuk është plotësisht e besueshme, besueshmërinë më të lartë në këtë të dhënë e kanë KRU 'Prishtina', 'Mitrovica' dhe 'Gjakova', ku të gjitha burimet i kanë të pajisura me ujëmatës dhe kanë një sistem të dokumentueshëm/verifikueshëm të raportimit, besueshmëria më e ultë për vitin 2023 është evidentuar tek KRU 'Hidrodrini' dhe 'Hidroregjioni Jugor', pasi për një numër burimesh prodhimi nuk është matur.

Me insistimin dhe mbështetjen e ARRU-së, KRU-të në fund të vitit 2023 kanë aprovuar Rregulloren për Instalimin dhe Leximin e Pajisjeve Matëse të Ujit, përmes të cilës KRU-të janë obliguar të instalojnë ujëmatës funksional në secilën pikë prodhimi dhe në secilën pikë konsumi të ujit, përfshirë edhe përgjegjësinë për mbajtje të dhënave dhe raportim të saktë.

Ankesat: Të gjitha KRU-të kanë në zbatim aplikacionin softuerik të përshtatshëm për menaxhimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Aplikacionet softuerike përkatëse nuk janë të integruara plotësisht në nivel regjional tek KRU 'Hidrodrini' por edhe tek KRU 'Mitrovica', ka vështirësi për evidentimin, klasifikimin dhe raportimin e ankesave sipas natyrës teknike dhe komerciale.

Kompanitë kanë procedura të shkruara rreth mënyrës së pranimit, trajtimit dhe regjistrimit të ankesave të cilat në përgjithësi me disa përjashtime të vogla zbatohen në tërësi.

Të dhënat për konsumatorët: edhe këto të dhëna nuk janë plotësisht të besueshme, përjashtuar KRU 'Hidromorava', Të dhënat mbahen në modulet e faturimit ku gjenerohen të dhëna sipas kërkesave të ARRU-së, në disa raste sistemi nuk ka mundur ndarjen e tyre sipas kërkesave për konsumatorët me matje dhe pa matje, në disa KRU ka pasur dallime të dhënave të konsumatorëve në mes të raporteve të cilat i gjeneron sistemi për këtë qellim.

Konsumatorët e regjistruar në modulin e faturimit nuk janë plotësisht të lidhura me sistemin GIS; kompanitë janë duke bërë azhurnimin e tyre edhe në këtë sistem.

Sa i përket procedurave për lidhje të reja dhe regjistrimit të tyre në regjistrin e konsumatorëve, është vërtetuar se disa prej KRU-ve nuk i zbatojnë në plotni afatet e përcaktuara ligjore, e në raste edhe dokumentacioni nuk është i kompletuar sipas kërkesave të ARRU-së.

Të dhënat për ujëmatësit: Aplikacioni softuerik i bazës së të dhënave të konsumatorëve lejon gjenerimin e listës së konsumatorëve me ujëmatës përfshirë të dhënat e vjetërsisë së ujëmatësit, në shumicën e KRU-ve, përjashtuar KRU 'Gjakova'.

Nga mostrat e marra vërtetohet se është bërë inspektimi dhe ka procesverbale nga tereni për zëvendësim të ujëmatësve, mirëpo ka mungesë në kompletimin e dokumentacionit.

Sa i përket instalimit të ujëmatësve, çdo konsumatori të ri të regjistruar i vendoset ujëmatësi funksional, kurse sa i përket zëvendësimit të ujëmatësve të vjetër / ekzistues, ka shumë punë për tu bërë në këtë drejtim. Ka ngecje të konsiderueshme për zëvendësimin periodik të ujëmatësve të vjetër; KRU-të ende nuk kanë plan për menaxhim të ujëmatësve.

